



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Onštine

Ne bazë të nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe nenit 5, pika (i) të Ligjit mbi arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L- 032 dhe nenit 84 të Ligjit të punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212 të dt.01.XI.2010, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2012, miratoi:

KODIN ETIK TË MËSIMDHËNËSVE DHE BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL NË TË GJITHA NIEVELET E ARSIMIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Betimi i mësuesit

“ Do ta kryej detyrimin tim me ndërgjegje dhe krenari. Nxënësit e mi nuk do të jenë vetëm nxënës, por edhe fëmijë dhe kurrë nuk do t'i harroj, që për fatin e tyre edhe vetë mbaj një pjesë të përgjegjësisë. Do ta mbroj me të gjitha mjetet ekzistuese nderin e profesionit të arsimit”

R. Dottrens, UNESCO, 1966

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kodi etik parashikon një sërë rregulla dhe parime etik, ndaj të cilave duhet t'i përmbahen të gjithë punonjësit dhe bashkëpunëtorët profesional të shkollës pa dallim pozite, moshe, gjinie, etnie, feje, përcaktimi politik etj.

Neni 2

Kodi etik rregullon të drejtat dhe detyrimet e mbajtësve të aktiviteteve të drejtpërdrejta edukativo-arsimore që kanë të bëjnë me sjellje dhe veshje të përshtatshme kundrejt punëtorëve të tjerë, kolegëve, nxënësve të shkollës, prindërve të nxënësve dhe palëve të tjera.

Neni 3

Mësimdhënësit dhe stafi profesional janë të detyruar të veprojnë në punën e tyre me ndërgjegje dhe me përgjegjësi të plotë në bazë të standardeve profesionale dhe në pajtim me parimet themelore të njerëzimit, moralit, humanizmit, drejtësisë, duke respektuar të drejtat ndërkombëtare të mbrojtura me ligj, sidomos duke marrë parasysh të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat njerëzore.

Mësimdhënësit dhe stafi profesional janë të detyruar t'i ruajnë fshehtësitë profesionale deri në publikimet e tyre zyrtare.

Mësimdhënësit dhe stafi profesional janë të detyruar t'i kushtojnë vëmendje të veçantë detyrave dhe obligimeve mësimore, të pranojnë vlerësimin real të aftësive të tyre dhe të përmirësohen për t'i kryer detyrat dhe obligimet në nivel sa më të lartë.

Mësimin dhe aktivitetet e tjera duhet t'i mbajnë rregullisht dhe sipas orarit të caktuar, ndërsa kur ka mungesa të kolegëve ta zëvendësojnë atë, nëse janë të lirë gjatë ditës së mungesës të mësimdhënësit me lejen e drejtorit të shkollës.

Mësimdhënësit janë të detyruar të marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore, në përputhje me aftësitë e tyre.

II. RAPORTI-MARRËDHËNIA MIDIS MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE

Neni 4

Mësimdhënësit dhe stafi profesional janë të obliguar që t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë nxënësit, pa diskriminim ose simpati në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, kombësisë, përkatësisë etnike apo fetare, statusit social apo ekonomik, gjendjes familjare, vendbanimit të caktuar ose ndonjë bazë tjetër.

Neni 5

Nxënësit duhet edukuar në përputhje me vlerat themelore të njeriut :mbi të vërtetën, paqen, sjelljen e drejtë, dashurin dhe jo dhunën, respektin dhe jo urrejtjen.

Neni 6

Mësimdhënësit dhe stafi profesional duhet të edukojnë nxënësit mbi parimin e arritjes së harmonisë në mendime, fjalë në vepër, çfarë duhet të jenë model dhe shembull për nxënësit dhe komunitetin, duke qëndrua gjithmonë në krye të detyrës dhe rolit që ka.

Neni 7

Nxënësit duhet të inkurajohen në qasje të lirë, të përgjegjshme dhe serioze për të mësuar me metodat më të mira profesionale, avancuese dhe shkencore.

Nxënësit duhet të jenë të motivuar për të mësuar dhe forma të tjera të krijimtarisë, inkurajohen të shprehin mendimet e tyre dhe të zhvillojnë besimin në to.

Neni 8

Mësimdhënësit duhet të jenë objektiv dhe të paanshëm në vlerësimin e nxënësve, të formoj besimin e plotë tek nxënësit dhe komuniteti për pavarësi ose interesa personale.

Neni 9

Është detyrë e mësimdhënësve dhe stafit profesional të respektojnë dhe të pranojnë nxënësit me aftësi dhe interesa të ndryshme, dhe t'ju sigurojnë atyre zhvillimin e duhur intelektual, emocional, moral dhe shpirtëror, në përputhje me aftësitë e tyre.

Neni 10

Tek nxënësit duhet të nxisë atdhedashurinë dhe patriotizmin, vetëdijen e përkatësisë kombëtare, vlerat e trashëgimisë historike, kulturore dhe etnike të Kosovës.

Neni 11

Duhet t'i kushtohet kujdes që tek nxënësit të krijojë respektin dhe dashurinë të të gjithë njerëzit pa dallim feje apo etnie në pajtueshmëri me konventat ndërkombëtare.

Neni 12

Është i ndaluar ndëshkimi fizik i nxënësve, dhe çdo metodë e presionit psikologjik që e sjell në një pozitë poshtëruese, ndjenjë të pa vlerë ose shkelje dinjiteti të nxënësit. Është e ndaluar të ndëshkohet mosbindja e nxënësve duke e larguar nga klasa, përpos nëse është larguar nga referimi i shërbimeve profesionale ose drejtori i shkollës.

Neni 13

Arsimtari apo stafi profesional për çdo informacion të formës së dhunës fizike dhe psikologjike apo të ndonjë sjelljeje tjetër poshtëruese ose të papranueshme që mund të dëmtojnë zhvillimin dhe integritetin fizik dhe psikologjik të nxënësit, duhet të lajmërojë menjëherë drejtorin e shkollës, i cili është i obliguar të lajmëroj organet përkatëse.

Neni 14

Gjithë mësime të nxënësve dhe stafi profesional i shkollës janë të obliguar të ruajnë në fshehtësi të dhënat e nxënësve dhe prindërve të tyre që kanë të bëjnë lidhur me njohurit që shkaktojnë përbuzje apo poshtërim për rrethin, pos në raste kur kërkohen nga organe kompetente.

III. MARRËDHËNIET MIDIS ARSIMTARËVE DHE PRINDËRVE

Neni 15

Mësime të nxënësve dhe stafi profesional duhet të jenë bashkëpunues me prindërit ose kujdestaret e tyre sepse janë bashkë-përgjegjës.

Neni 16

Me kërkesën e prindërve ose kujdestarëve të nxënësve mësime të nxënësve janë të obliguar ta pranojnë në bisedë nëse nuk e pengon procesin e rregullt mësimor.

Nga mësime të nxënësve duhet të jetë i caktuar orari për pranimin e bisedave për prindërit apo kujdestarët e interesuar të fëmijëve.

Neni 17

Marrëdhëniet e arsimtarëve dhe personelit profesional me prindërit ose kujdestarët e fëmijëve duhet të jetë tolerant dhe frytdhënës në llogari të mirëqenies dhe prosperitetit të nxënësve. Gjithë mësime të nxënësve dhe stafi profesional duhet të përmbahen nga të gjitha format e korrupsionit, dhe të zhvillojnë aktivitet për ndërgjegjësim dhe të tjerët.

Neni 18

Arsimtarët janë të detyruar të informojnë prindërit ose kujdestarët për suksesin e nxënësve, sjelljet e tyre, aktivitetet dhe mungesat në mësim.

Çdo arsimtarë i shkollës duhet ta ruaj dinjitetin e kolegut të vet karshi: nxënësve, komunitetit dhe prindërve të nxënësve.

IV. MARRËDHËNIET E MËSIMDHËNËSVE MES VETI NDAJ PALËVE DHE PUNËTORËVE TJERË TË SHKOLLËS

Neni 19

Marrëdhënia e mësimdhënësve dhe stafit profesional ndaj detyrave dhe obligimeve duhet të jetë në nivel me kompetencë dhe profesionalizëm.

Neni 20

Marrëdhëniet reciproke të arsimtarëve dhe stafit profesional duhet të jenë në nivel të duhur duke u bazuar në respekt, kolegjalitetit, barazi, solidaritet, ndihmë profesionale dhe vlera njerëzore.

Neni 21

Mësimdhënësit dhe stafi profesional janë të detyruar që të përmbahen nga sjelljet që mund të shkelin reputacionin profesional të kolegëve të vet, po ashtu dhe punonjësit tjetër të shkollës çfarëdo pozite qoftë ai.

Në adresimin e veprimeve specifike ndaj sjelljeve të kolegëve të tjerë, apo punonjësve të tjerë të shkollës duhet trajtuar në mënyrë të drejtë dhe me kujdes, gjatë vërejtjeve apo kritikave, në mënyrë që të mos e dëmtojnë reputacionin apo dinjitetin e personit për të cilin bëhet fjalë.

Asnjë punëtor i shkollës nuk ka të drejtë që të shfrytëzojë pozitën e vet për të urdhëruar apo përdorur punëtorin tjetër për interesa të veta ose grupe.

Neni 22

Ndaj palëve që kërkojnë ndihmë për të kryer punë në shkollë, punonjësit janë të obliguar në mënyrë njerëzore dhe miqësore t'i afrojnë informacionin e duhur dhe të sillen në pajtueshmëri me rregullat e shkollës.

Neni 23

Trajtimi i nxënësve, prindërve, punëtorëve të shkollës dhe të gjithë personave tjerë, me të cilët komunikohet, duhet të jetë në mënyrë njerëzore, kulturore, të sjellshme dhe nivel profesional, pa marr parasysh moshën, pozitën, nivelin e shkollimit, përcaktimit etnik, politik, fetar ose ndonjë baze tjetër.

V. DISPOZITA TË TJERA

Neni 24

Dukja personale e mësimdhënësve dhe stafit profesional duhet të jetë zyrtare dhe serioze në respekt të profesionit, funksionit edukativ dhe njerëzor.

Veshja e mësimdhënësve dhe stafi profesional duhet të jetë i pastër, modeste, e rregulluar dhe e madhësisë të përshtatshme.

Veshja e femrave nuk duhet të jetë e ngushtë dhe e shkurtër, e papërshtatshme për të zbuluar ndonjë pjesë të trupit, në mënyrë që të mos ndikojë negativisht në vëmendjen e nxënësve.

Neni 25

Personeli arsimor është i detyruar të ruajë dinjitetin e profesionit dhe jashtë orarit të punës në shkollë, të kenë sjellje të përshtatshme, respektuese dhe dinjitoze.

Neni 26

Është detyrë e çdo punëtori të shkollës që vëren sjellje të pahijshme apo ndonjë veprim në kundërshtim me normat etike të përgjithshme ose me këtë kod etik që t'ja tërheq vërejtjen

nëse nuk merr masat e përmirësimit të menjëhershëm ta lajmërojë ek organet kompetente të shkollës.

Neni 27

Ndalohet në mënyrë absolute çdo sjellje e papranueshme: diskriminimi, ngacmimi, ngacmimi seksual ose verbal, konsum të alkoolit ose pije të ngjashme, pirja e duhanit, narkotikëve dhe pijeve tjera të ndaluara me ligj.

Shkelësit e këtij kodi etik mundë të konsiderohen shkelje profesionale dhe shkelje të lehta ose të rënda të vendit të punës e që ndëshkimi jepet sipas ligjeve në fuqi.

Neni 28

Kodi etik duhet të respektohet nga të gjithë punonjësit e shkollës me datën e hyrjes në fuqi.

Çdo punëtorë i ri që krijon marrëdhënie pune të re para se të nënshkruaj kontratën duhet të njihet me këtë kod etik.

Neni 29

Për të monitoruar zbatimin e dispozitave të kodit të etik dhe të detyrimeve në pajtueshmëri me të, këshilli drejtues formon një Komision për Etik.

Komisioni Etik ka 3 anëtarë dhe zgjidhet me vota të hapëta dhe ka mandat dy vjeçar.

Kryetari zgjidhet nga vetë anëtarët e komisionit me mandat 1 vjeçar.

Komisioni është i pavarur në punën e tij, ndërsa së paku një herë në vit i raporton Këshillit të arsimtarëve.

Komisioni, përpos masave të veta ndëshkimore që kanë të bëjnë me shkelje të lehta si vërejtje me gojë dhe me shkrim, po ashtu ju propozon: Drejtorit, bordit dhe këshillit të arsimtarëve të shkollës, për masa të tjera në bazë të ligjeve në fuqi.

Neni 30

Gjithë personeli punonjës, nxënësit, prindërit, kujdestarët dhe qytetarë të tjerë, të cilët besojnë se njëri apo grup që i nënshtrohen zbatimit të këtij kodi etik e keqpërdorin ose e shkelin në çfarëdo forme, mund të paraqesin ankesë për shqyrtim të rastit të këshilli drejtues i shkollës me gojë ose me shkrim.

Neni 31

Me aprovimin e këtij kodi etik, pushojnë të gjitha rregullat ose kodet e më hershme që kanë qenë në fuqi.

Kodi Etik është miratuar nga Kuvendi Komunal: 30.03.2012.

01 Nr. 1672
Rahovec, 30.03.2012

Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa